



**COVID-19
VACCINE**
Public Health
Advice



Vaksina Comirnaty (Pfizer/
BioNTech) për fëmijët e moshës
6 muajsh deri në 4 vjeç

Informacion i rëndësishëm për
prindërit dhe kujdestarët

Versioni 2
8 maj 2023



Rialtas na hÉireann
Government of Ireland

Rreth kësaj fletëpalosjeje

Kjo fletëpalosje ju tregon rreth vaksinës së COVID-19 (koronavirusit) për fëmijët e moshës 6 muajsh deri në 4 vjeç.

Ajo ju tregon:

- COVID-19 në fëmijët e moshës 6 muajsh deri në 4 vjeç
- çfarë është vakcina COVID-19
- përfitimet e vaksinimit për fëmijët e moshës 6 muajsh deri në 4 vjeç
- rreziqet e vaksinimit për fëmijët e moshës 6 muajsh deri në 4 vjeç
- siguria dhe efektet anësore të vaksinës
- çfarë të prisni pas vaksinës COVID-19
- si të jepni miratim për vaksinën COVID-19
- ku mund të merrni më shumë informacion

Ju lutemi lexojeni këtë fletëpalosje me kujdes. Qëllimi ynë për këtë fletëpalosje informacioni është t'ju lejojmë të merrni një vendim të informuar rreth vaksinimit të fëmijës suaj. Mund të flisni edhe me një profesionist të kujdesit shëndetësor, si për shembull me mjekun tuaj të përgjithshëm (mjekun) ose farmacistin, rreth vaksinës.

Ju mundeni gjithashtu:

- të lexoni Fletëpalosjen e Informacionit për Pacientët të disponueshme në faqen **www.hse.ie/covid19vaccinePIL**
- të lexoni tregimin me komikë të HSE-së, “Bërja e vaksinës së COVID-19” – ky mund të jetë i përshtatshëm për ta lexuar me fëmijën tuaj (kodi QR që të çon te tregimi me komikë ndodhet në fund të kësaj fletëpalosjeje)
- të lexoni informacion të mëtejshëm të disponueshëm në faqen **www.hse.ie**

Rreth COVID-19

COVID-19 është një sëmundje që mund të prekë mushkëritë dhe rrugët e frymëmarrjes dhe nganjëherë disa pjesë të tjera të trupit. Ajo shkaktohet nga një virus që quhet coronavirus.

COVID-19 është shumë infektues. Ai përhapet nëpërmjet ajrit përmes stërkalave që krijohen kur njerëzit kolliten ose teshtijnë ose kur ata prekin sipërfaqe ku kanë rënë stërkalat dhe ata prekin sytë, hundën ose gojën e tyre.

Simptomat më të zakonshme të COVID-19 janë:

- një temperaturë (temperaturë e lartë prej 38 gradë celsius ose më e lartë) - përfshirë të dridhura
- kollë e thatë
- lodhje

mund të duhen 14 ditë pas ekspozimit ndaj COVID-19 që të shfaqen simptomat. Simptomat mund të jenë të ngjashme me ato të ftohjes ose gripit. Fëmija juaj mund të mos i ketë të gjitha këto simptoma ose mund të ndihet në përgjithësi jo aq mirë sa zakonisht.

Nëse fëmija juaj ka ndonjë simptomë të COVID-19, ju duhet ta mbani atë në shtëpi deri në 48 orë pasi të ndjehet më mirë. Ju mund të kontrolloni faqen **www.hse.ie** për të parë nëse ata kanë nevojë për një test COVID-i.

Për më shumë informacion mbi COVID-19, ju lutemi vizitoni **www.hse.ie/coronavirus** ose telefononi HSELive në numrin **1800 700 700**.

COVID-19 dhe fëmijët e moshës 6 muajsh deri në 4 vjeç

Pjesa më a madhe e fëmijëve në këtë grupmoshë që infektohen me COVID-19 kanë simptoma shumë të lehta ose asnjë simptomë.

COVID-19 mund të shkaktojë sëmundje serioze, shtrim në spital ose vdekje në fëmijët por kjo është shumë e rrallë. Megjithëse rreziku për shtrim në spital dhe sëmundje serioze është shumë i ulët në këtë grupmoshë, ai është më i lartë se në fëmijët më të rritur.

Ndonjëherë, simptomat e lidhura me COVID-19 mund të vazhdojnë për disa javë ose muaj. Ky quhet 'COVID i gjatë'. Rreziku i kësaj gjendjeje është më i ulët në fëmijët krahasuar me të rriturit.

Rreziku i një fëmije për t'u shtruar në spital me COVID-19 është shumë i ulët dhe rreziku që një fëmijë të ketë nevojë për kujdes intensiv është jashtëzakonisht i ulët.

Fëmijët me kushte të caktuara shëndetësore janë në rrezik më të lartë për t'u sëmurur rëndë dhe shtruar në spital nëse infektohen me COVID-19. Megjithatë, më shumë se gjysma e fëmijëve në spital me COVID-19 mund të mos kenë ndonjë gjendje mjekësore ekzistuese.

Rrallë, COVID-19 mund të shkaktojë një gjendje të quajtur Sindroma Inflamatore Multisistemike në fëmijët (MIS-C).

Kjo gjendje shkakton pneumoni, inflamacion të zembrës dhe vështirësi në frymëmarrje. Shumica e fëmijëve me MIS-C shërohen pas disa kohësh në spital ose në kujdesin intensiv por disa fëmijë kanë efekte anësore që zgjasin dhe vetëm një numër shumë i vogël vdesin.

Çfarë është vakcina COVID-19?

Një vaksinë është një substancë që duhet të përmirësojë imunitetin (mbrojtjen) ndaj një sëmundjeje të veçantë. Vaksinat mësojnë sistemin imunitar si të mbrojnë njerëzit nga sëmundjet.

Të dhënat e disponueshme tregojnë se vakcina COVID-19 duhet t'i sigurojë fëmijës suaj mbrojtje nga COVID-19. Nëse fëmijët vaksinohen, kjo duhet të ndihmojë edhe në reduktimin e numrit të atyre që sëmuren rëndë ose që vdesin nga COVID-19 në komunitetin tonë.

Çfarë vaccine po i ofrohet fëmijës tim?

Vaksina që po i ofrohet fëmijës suaj quhet Comirnaty (Pfizer/BioNTech).

Kjo është një vaksinë mRNA-je që i mëson trupit të fëmijës suaj si të krijojë një proteinë që do të nxisë një reagim imunitar pa përdorur virusin e gjallë që shkakton COVID-19.

Më pas trupi i fëmijës suaj do të krijojë antitrupa që ndihmojnë në luftën kundër infeksionit nëse virusi i COVID-19 hyn në trupin e tij në të ardhmen.

Përpara vaksinimit do ju kërkohet të jepni miratim që fëmija juaj të marrë vaksinën dhe ky miratim do të regjistrohet.

Pse vakcina po ofrohet për të gjithë fëmijët e moshës 6 muajsh deri në 4 vjeç?

Arsyeja përse ne ia ofrojmë vaksinën kësaj popullate është që të mbrojmë njerëzit dhe të reduktojmë sëmundjen dhe vdekjet e shkaktuara nga ky virus.

Marrja e vaksinës COVID-19 duhet të mbrojë fëmijën tuaj dhe ata rreth tyre nga infektimi me COVID-19. Megjithatë të sëmururit rëndë nga COVID-19 është i rrallë në këtë grupmoshë, ata janë edhe më pak të predispozuar të sëmuren rëndë me COVID-19 nëse janë të vaksinuar.

Vaksinat COVID-19 rekomandohen nga Komiteti Këshillimor Kombëtar për Imunizimin (NIAC) për fëmijët e moshës 6 muajsh deri në 4 vjeç të cilët kanë një gjendje shëndetësore që i vendos ata në rrezik të lartë për t'u sëmurur rëndë nëse infektohen me COVID-19.

Për të gjithë fëmijët e kësaj grupmoshe, rekomandimi nga NIAC është që përfitimet e vaksinimit janë më të mëdha se rreziqet nga vakcina, që do të thotë se kësaj grupmoshe mund t'i ofrohet vakcina.

Përfitimet përfshijnë mosinfektimin me COVID-19 dhe mbrojtje shtesë nga rreziqet e rralla të të sëmururit rëndë me COVID-19.

Vaksinimi i fëmijëve mundet gjithashtu të reduktojë transmetimin të personat e tjerë në shtëpi, për shembull, të ata me sistem të dobësuar imunitar. Fëmijët të cilët janë vaksinuar do kenë më pak gjasa të humbasin shkollën dhe aktivitete të tjera për shkak të COVID-19.

A është vakcina efektive për fëmijët e moshës 6 muajsh deri në 4 vjeç?

Prova klinike për vaksinën Comirnaty (Pfizer/BioNTech) tregoi se ajo ishte e efektshme në parandalimin e COVID-19 në fëmijët e kësaj moshë pas tre dozash. Është gjithashtu shumë e efektshme në parandalimin e sëmundjes serioze që mund të çojë në shtrim në spital me COVID-19.

A është vakcina e sigurt për fëmijët e moshës 6 muajsh deri në 4 vjeç?

Komiteti Kombëtar Këshillues i Imunizimit rekomandon që fëmijëve të moshës 6 muajsh deri në 4 vjeç t'u ofrohet kjo vaksinë COVID-19.

Vaksina është testuar në mijëra njerëz përfshirë mbi 3,000 fëmijë të moshës 6 muajsh deri në 4 vjeç si pjesë e provave klinike. Për fëmijët e kësaj grupmoshe nuk u vërejt asnjë shqetësim shtesë sigurie në prova klinike.

Kjo vaksinë ka plotësuar gjithashtu standarde të rrepta të sigurisë, cilësisë dhe efektshmërisë dhe është miratuar e licencuar nga rregullatorët.

Për Irlandën, rregullatori është Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) - vizitoni **www.ema.europa.eu** për më shumë informacion.

Për t'u miratuar për përdorim, vakcina ka kaluar të gjitha provat klinike dhe kontrollet e sigurisë që kalojnë të gjitha barnat e licencuara, sipas standardeve ndërkombëtare të sigurisë. Monitorimi i sigurisë së gjithë vaksinave të COVID-19 rishikohet vazhdimisht nga autoritetet përkatëse.

Ndërkohë që puna për të zhvilluar vaksinat COVID-19 ka ecur përpara shumë më shpejt sesa zakonisht, vakcina që po i ofrojmë fëmijës suaj ka kaluar të gjitha hapat e nevojshme për të zhvilluar dhe miratuar një vaksinë të sigurt dhe të efektshme.

Ne jemi ende duke mësuar rreth efektshmërisë dhe efekteve anësore të vaksinave COVID-19 në këtë grupmoshë.

Të gjithë barnat kanë efekte anësore dhe ju duhet të lexoni rreth efekteve anësore të zakonshme, të rralla dhe shumë të rralla të kësaj vaccine në këtë fletëpalosje përpara se të jepni miratimin që fëmija juaj të vaksinohet.

Fëmija im e ka kaluar COVID-19, a mund ta bëjë vaksinën?

Nëse fëmija juaj ka kaluar COVID-19 ai me shumë gjasa do ketë pak imunitet.

Edhe nëse fëmija juaj e ka kaluar COVID-19, ai mund të infektohet sërish me të. Kjo vaksinë do të reduktojë rrezikun e infektimit me COVID-19 sërish.

A mundet fëmija im ta bëjë vaksinën COVID-19 nëse ka një temperaturë të lartë?

Jo. Ju duhet ta shtyni bërjen e vaksinës nëse fëmija ka temperaturë (temperaturë prej 38 gradë celsius ose më të lartë), derisa ai të ndihet më mirë.

A mundet vakina ta infektojë fëmijën tim me COVID-19?

Jo. Vakina COVID-19 nuk mund ta infektojë fëmijën tuaj me COVID-19. Mundet që fëmija të jetë infektuar me COVID-19 përpara se të bënte vaksinën dhe të mos e ketë kuptuar që ka simptoma deri pas bërjes së vaksinës.

Nëse fëmija juaj ka ndonjë simptomë të COVID-19 - ose nëse ka një temperaturë që fillon më shumë se 2 ditë pas vaksinës apo zgjat më shumë se 2 ditë - ai duhet të vetë-izolohet (të qëndrojë në shtëpi) deri në 48 orë pasi të ndjehet mirë. Ju mund të kontrolloni faqen **www.hse.ie** për të parë nëse ata kanë nevojë për një test të COVID-19.

Kush është vaksinuesi i fëmijës tim?

Ky është personi që i bën atij vaksinën. Ata janë trajnuar nga HSE-ja që të bëjnë vaksinat ndaj COVID-19.

Si jepet vakina e COVID-19?

Vakina COVID-19 jepet si një injeksion në kofshë ose në pjesën e sipërme të krahut, në varësi të moshës së fëmijës tuaj. Kjo gjë zgjat vetëm pak minuta.

Sa doza të vaksinës COVID-19 do ketë nevojë fëmija im?

Ai do të ketë nevojë për 3 doza të vaksinës Pfizer/BioNTech për mbrojtjen më të mirë të mundshme nga COVID-19. Fëmija juaj do të marr dozën e dytë 3 javë pas dozës së parë, ndjekur nga një dozë e tretë 8 javë pas dozës së dytë.

Fëmija im ka COVID-19 për momentin, a mund ta bëjë ai vaksinën?

Nëse fëmija juaj ka COVID-19 dhe dozës së parë të vaksinës i ka kaluar afati:

- ai mund të vaksinohet 4 javë nga zhvillimi fillestar i simptomave ose nga testimi pozitiv me COVID-19. Megjithatë, që vakcina e tij të jetë sa më e efektshme, rekomandohet të pritet 6 muaj në mënyrë që vakcina të jetë sa më e efektshme.

Nëse fëmija juaj ka COVID-19 dhe dozës së dytë ose të tretë të vaksinës i ka kaluar afati:

- ai mund të vaksinohet 4 javë nga zhvillimi fillestar i simptomave ose nga testimi pozitiv me COVID-19.

Nëse fëmija juaj ka COVID-19 dhe dozës së tretë të vaksinës i ka kaluar afati, nëse ata:

- kanë një infeksion me COVID-19 jo më shumë se 7 ditë pas dozës së dytë, nuk kërkohet një dozë e tretë
- kanë një infeksion me COVID-19 brenda 7 ditëve nga doza e tyre e dytë, ata duhet të bëjnë një dozë të tretë 8 javë pas zhvillimit të simptomave të para ose testimit pozitiv për COVID-19

Cilat janë efektet anësore të vaksinës?

Sikurse të gjitha barnat, vaksinat mund të shkaktojnë efekte anësore. Shumica prej tyre janë të lehta deri mesatare, afatshkurtër dhe jo të gjithë i kalojnë ato.

Më shumë se 1 në 10 fëmijë mund të kenë këto **efekte anësore shumë të zakonshme:**

- nervozizëm
- përgjumje
- rënie të oreksit
- të ndihen të lodhur
- të jenë pak të ndjeshëm ose të kenë ënjtje në krahun ku është bërë injeksioni i vaksinës
- skuqje në vendin ku është bërë vakcina
- të kenë dhimbje koke
- të kenë dhimbje muskujsh
- të kenë dhimbje kyçesh
- të kenë diarre
- të kenë temperaturë (temperaturë prej 38 gradë celsius ose më e lartë) ose të dridhura

Deri në 1 në 10 fëmijë mund të kenë këto **efekte anësore të zakonshme:**

- skuqje (6 deri në 23 muajsh)
- të përziera
- të vjella

Deri në 1 në 100 fëmijë mund të kenë këto **efekte anësore të pazakonshme:**

- të kruajtura në vendin ku është bërë vaksina
- kruajtje të përgjithshme
- ënjtje të gjëndrave limfatike
- pagjumësi
- djersitje të tepërt
- djersitje në gjumë
- mungesë energjie, gjendje letargjie ose ndjesi parahatie
- dhimbje në krahun e vaksinuar

Deri në 1 në 1,000 fëmijë mund të kenë këto **efekte anësore të rralla:**

- varje të përkohshme në një rën anë të fytyrës
- reaksione alergjike si urtikarie ose ënjtje të fytyrës

Deri në 1 në 10,000 fëmijë mund të kenë këto **efekte anësore shumë të rralla:**

- miokardit dhe perikardit

Të dhëna të hershme nga vende të tjera tregojnë se miokarditi ka më pak predispozitë në personat e moshës 12 deri në 15 vjeç se në personat e moshës 16 deri në 24 vjeç. Miokarditi në fëmijët e moshës 6 muajsh deri në 4 vjeç është shumë i rrallë. Në Shtetet e Bashkuara, mbi një milion doza të vaksinave të mRNA-së i janë dhënë fëmijëve në këtë grupmoshë. Nuk ka pasur raportime të miokarditit në këto fëmijë. Ne jemi ende duke mësuar rreth efektshmërisë dhe efekteve anësore të vaksinave COVID-19 në këtë grupmoshë.

Miokarditi dhe perikarditi janë gjendje inflamatore të zemrës. Rreziku i këtyre gjendjeve shumë të rralla është më i lartë te djemtë e rinj. Këto kushte kanë më shumë gjasa të shfaqen pas dozës së dytë të vaksinës dhe ndodhin më shumë brenda 14 ditëve pas marrjes së vaksinës.

Dy studime evropiane kanë vlerësuar rrezikun e miokarditit pas dozës së dytë të vaksinës:

- Një rast shtesë për çdo 38 000 burra të moshës 12 deri në 29 vjeç (brenda 7 ditësh)
- Një rast shtesë për çdo 17, 500 burra të moshës 16 deri në 24 vjeç (brenda 28 ditësh)

Shumica e njerëzve shërohen vetë ose me trajtim mbështetës por kanë nevojë për kujdes spitalor. Ne nuk e dimë ende nëse ka ndonjë problem afatgjatë të lidhur me këto efekte anësore.

Ende nuk dihet sa persona që e marrin këtë vaksinë do të përjetojnë këto efekte anësore por mendohet se ato janë **jashtëzakonisht të rralla**:

- një reaksion alergjik i rëndë. Vaksinuesi juaj është i trajnuar që të trajtojë reaksione alergjike të rënda
- Eritema Multiforme, një reaksion në lëkurë që shkakton njolla të kuqe ose njolla në lëkurë që mund të duken si një objektiv ose 'shenjë' me një qendër ngjyrë të kuqe të errët rrethuar nga rathë ngjyrë të kuq të zbehtë
- fryrje të konsiderueshme të krahut (ose këmbës) në vendin ku është bërë vaksina
- ndjesi shpimi ose humbje të ndjeshmërisë në disa pjesë të trupit

Vaksina e COVID-19 ka kaluar nëpër të njëjtat prova klinike dhe kontrollë të sigurisë sikurse dhe të gjitha vaksinat e tjera të licencuara, megjithatë vaksina është e re ndaj informacioni mbi efektet anësore afatgjata është i kufizuar.

Ndërkohë që shumë njerëz në Irlandë dhe nëpër botë e bëjnë këtë vaksinë, mund të ketë në dispozicion më shumë informacion rreth efekteve anësore. HSE-ja do ta përditësojë këtë informacion rregullisht në faqen tonë të internetit dhe nëse është e nevojshme, do të përditësojë fletëpalosjet e informacionit që iu jepen njerëzve në takimin e tyre për dozën e tyre të parë ose të dytë të vaksinimit.

Simptomat e miokarditit dhe perikarditit

Shumë rrallë, njerëzit mund të zhvillojnë miokardit dhe perikardit pas marrjes së vaksinës Comirnaty (Pfizer/BioNTech). Miokarditi dhe perikarditi janë gjendje inflamatore të zemrës.

Ju duhet të dini shenjat që duhet të kërkonti në fëmijën tuaj. Kërkonti ndihmë mjekësore nëse fëmija juaj shfaq ndonjë prej këtyre simptomave pas vaksinës:

- pamundësi për të marrë frymë
- palpitacione (rrahje të forta zemre që mund të jenë të çrregullta)
- dhimbje kraharori

Shenjat e miokarditit në fëmijët më të vegjël mund të jenë më shumë jo-specifike duke përfshirë:

- nervozizëm
- të vjella
- vështirësi në të ushqyer
- frymëmarrje të shpejta dhe të shkurtra
- lodhje

A ka fëmijë të cilët nuk duhet ta marrin vaksinën COVID-19?

Po. Fëmija juaj nuk duhet ta marrë vaksinën COVID-19 Comirnaty (Pfizer/BioNTech) nëse:

- ka pasur një reaksion alergjik të rëndë ndaj ndonjë përbërësi në vaksinë (përfshi polietilen glikolin ose PEG). Lexoni Fletëpalosjen e Informacionit për Pacientët në www.hse.ie/covid19vaccinePIL për të parë listën e përbërësve.
- ka pasur një reaksion alergjik të rëndë ndaj një doze të mëparshme të vaksinës Pfizer/BioNTech.
- ka pasur një reaksion alergjik të rëndë ndaj Trometamol (një përbërës në bojën e kontrastit i përdorur në studimet radiologjike të MRI-së).

Bisedoni me mjekun e fëmijës suaj përpara se të bëni vaksinën e COVID-19 nëse ai:

- ka pasur një reaksion të rëndë alergjik (anafilaksi) në të shkuarën përfshirë ndaj ndonjë vaksine ose mjekimi tjetër.
- ka pasur miokardit ose perikardit pas një doze të mëparshme të vaksinës COVID-19.

Nëse fëmija juaj ka shfaqur më parë Sindromën Inflamatorë Multisistemike ai mund ta bëjnë vaksinën COVID-19 pasi të jetë shëruar dhe të paktën 90 ditë pas diagnozës, cilado periudhë të jetë më e gjatë.

Si një masë paraprake, nëse fëmija juaj ka marrë së fundmi vaksinën e lisë së majmunit (Imvanex ose Jynneos), ai duhet të presë 4 javë përpara se të bëjë vaksinën COVID-19 për shkak të rreziqeve të panjohura të miokarditit.

Vaksinat e tjera duhet të ndahen nga vaksinat COVID-19 me 14 ditë në këtë grupmoshë. Vaksinat rutinë duhet të kenë prioritet në fëmijët e kësaj grupmoshe.

Shumica e fëmijëve do kenë mundësi ta bëjnë vaksinën në mënyrë të sigurt. Personi që do i bëjë vaksinën fëmijës suaj do iu përgjigjet me kënaqësi pyetjeve që keni në takimin për të bërë vaksinën.

Ata do ju japin edhe këshilla për kujdesin e mëtejshëm dhe një kartë ku të jetë shënuar emri dhe numri i grupit të vaksinës që i është dhënë fëmijës suaj.

Pas bërjes së vaksinës

Ne po ju japim edhe një rekord të vaksinimit të fëmijës suaj sot.

Ju lutemi mbajeni kartën e bërjes së vaksinës të sigurt.

Çfarë mund të ndodhë në ditët e ardhme?

Disa persona që e bënë vaksinën që bëri fëmija juaj sot mund të shfaqin disa prej efekteve anësore të listuara më herët. Shumica e këtyre efekteve janë të lehta në mesatare dhe zgjasin pak.

Temperatura pas vaksinimit

Është shumë e zakonshme të keni temperaturë pas një vaksinimi. Kjo ndodh zakonisht brenda 2 ditësh pasi e keni bërë vaksinën dhe largohet brenda 2 ditësh. Ka më shumë të ngjarë që fëmija juaj të ketë temperaturë pas dozës së dytë të vaksinës.

Nëse fëmija juaj nuk ndihet rehat, jepini paracetamol ose ibuprofen siç udhëzohet në kuti ose fletëpalosje. Nëse jeni i shqetësuar për fëmijën tuaj, ju lutemi kërkon këshilla mjekësore.

Sa kohë duhet që vaksina të funksionojë?

Pas marrjes së tre dozave të vaksinës së COVID-19, shumica e fëmijëve kanë imunitet. Kjo do të thotë se ata do të jenë të mbrojtur ndaj COVID-19. Duhet 7 ditë pasi të bëhet doza e tretë e vaksinës që ajo të funksionojë. Ka një mundësi që fëmija juaj sërish të infektohet me COVID-19 edhe nëse e ka bërë vaksinën.

A funksionon vakcina tek të gjithë?

Vaksinat janë përdorur në miliona njerëz anembanë botës. Ka prova të forta dhe të besueshme se vaksinat COVID-19 reduktojnë shumë rrezikun e infektimit me COVID-19. Ato janë shumë efikase në parandalimin e vdekjeve dhe të sëmururit rëndë me COVID-19.

Vaksinat nuk veprojnë njësoj në çdo person dhe është akoma e mundur të infektohesh me COVID-19 pas vaksinimit. Nëse fëmija juaj ka një sistem imunitar të dobësuar, nuk ka rrezik shtesë me bërjen e vaksinës por ajo mund të mos funksionojë po aq mirë për fëmijën tuaj.

Sa kohë zgjat imuniteti nga vakcina?

Ne nuk e dimë ende se sa kohë do të vazhdojë imuniteti. Provat klinike po vazhdojnë për ta mësuar këtë gjë.

Kur fëmija im të bëjë vaksinën, a do të thotë kjo që ai nuk do e përhap COVID-19 tek të tjerët?

Ne nuk e dimë ende nëse bërja e vaksinës pengon njerëzit që ta përhapin virusin COVID-19 tek të tjerët. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që ne të gjithë të vazhdojmë të ndjekim këshillat e shëndetit publik se si ta ndalojmë përhapjen e virusit.

A mundet fëmija im të bëjë vaksinën COVID-19 dhe vakcina të tjera?

Si një masë paraprake, nëse fëmija juaj ka marrë së fundmi vaksinën e lisë së majmunit (Imvanex ose Jynneos), ai duhet të presë 4 javë përpara se të bëjë vaksinën COVID-19 për shkak të rreziqeve të panjohura të miokarditit.

Vaksinat e tjera duhet të ndahen nga vaksinat COVID-19 me 14 ditë. Vaksinat e hershme të fëmijërisë duhet të kenë prioritet mbi vaksinat COVID-19.

Miratimi për vaksinimin e fëmijës suaj

Një prind ose kujdestar ligjor do kërkohet të jap miratim për çdo fëmijë që do vaksinohet.

Vendimi juaj për të dhënë miratim për vaksinën ose jo do të respektohet. Tabela e mëposhtme përmbledhëse mund të jetë e dobishme për t'ju informuar rreth zgjedhjeve tuaja.

Konsideroni vaksinimin e fëmijës suaj nëse:	Konsideroni mosvaksinimin e fëmijës suaj apo pritjen derisa të paraqitet më shumë informacion, nëse:
<ul style="list-style-type: none"> Fëmija juaj ka një gjendje mjekësore ekzistuese që e vendos atë në rrezik të lartë të të sëmururit rëndë me COVID-19. Fëmija juaj jeton me një fëmijë ose të rritur që është në rrezik të lartë për t'u sëmurur rëndë me COVID-19. Ju doni të shtoni mbrojtjen e fëmijës suaj ndaj mundësisë jashtëzakonisht të rrallë të të sëmururit rëndë me COVID-19, Sindromës Inflamatore Multisistemike ose 'COVID-it të gjatë'. 	<ul style="list-style-type: none"> Ju nuk doni të rrezikoni efektin anësor shumë të rrallë të miokarditit dhe perikarditit nga vaksinimi. Ju doni të prisni deri sa të jetë i disponueshëm më shumë informacion rreth rrezikut të Sindromës Inflamatore Multisistemike dhe COVID-19 në fëmijët. Ju doni të prisni deri sa të paraqitet më shumë informacion rreth efekteve afatgjata të vaksinave në fëmijët dhe të rinjtë.

Përfitimet e vaksinës	Rreziqet e vaksinës
<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja nga COVID-19. Mbrojtje për fëmijët që kanë kushte shëndetësore që i vendosin ata në rrezik të lartë për t'u sëmurur rëndë me COVID-19. Mbrojtje për fëmijët e shëndetshëm nga të sëmururit rëndë me COVID-19 - megjithëse kjo gjë është shumë e rrallë në këtë grupmoshë. Rreziku i një fëmije për t'u shtruar në spital me COVID-19 është shumë i ulët dhe rreziku që një fëmijë të ketë nevojë për kujdes intensiv është jashtëzakonisht i ulët. Mbrojtje nga COVID-19 dhe nga ndërlikimet e COVID-19 si 'COVID-i i gjatë' dhe Sindroma Inflamatore Multisistemike te fëmijët. Mund të ndihmojë në parandalimin e përhapjes së COVID-19 te të tjerët. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse fëmijët dhe të rinjtë jetojnë me një motër/vëlla ose me një të rritur i cili është në rrezik për t'u sëmurur rëndë me COVID-19. 	<ul style="list-style-type: none"> Efekte afatshkurtra si dhimbje krahu, temperaturë ose lodhje. Rreth 1 në 100 000 persona mund të shfaqin një efekt anësor serioz si një reaksion alergjik ndaj vaksinës. Shumë rrallë disa njerëz zhvillojnë inflamacion të zemrës (miokardit) dhe të shtresës së jashtme të zemrës (perikardit) pas vaksinimit. Shumica e njerëzve e marrin veten nga miokarditi dhe perikarditi por ata mund të kenë nevojë për trajtim spitalor. Ne nuk kemi ende informacion rreth efekteve afatgjata të vaksinave COVID-19 në fëmijët.

Informacion shtesë

Për më shumë informacion, lexoni Fletëpalosjen me Informacion për Pacientin. Kjo fletëpalosje do printohet për ju në ditën që fëmija juaj do bëjë vaksinën ose ju mund ta gjeni atë në faqen

www.hse.ie/covid19vaccinePIL

Ju mund të flisni edhe me një profesionist të shëndetit, si për shembull me një mjek të përgjithshëm (doktor), farmacist ose ekip të kujdesit shëndetësor.

Mund të vizitoni edhe faqen e internetit të HSE-së në

www.hse.ie/covid19vaccine ose të telefononi HSELive në numrin 1800 700 700.

Për më shumë informacion mbi vaksinën e COVID-19, përfshirë materiale në formate të aksesueshme dhe të përkthyer, vizitoni

www.hse.ie/covid19vaccinematerials

Si t'i raportoj efektet anësore?

Sikurse me të gjitha vaksinat, ju mund t'i raportoni efektet anësore të dyshuara te Autoriteti Rregullator i Produkteve (HPRA).

HPRA-ja është autoriteti rregullator në Republikën e Irlandës për barnat, pajisjet mjekësore dhe produktet e tjera të shëndetit. Si pjesë e rolit të tij në monitorimin e sigurisë së barnave, HRPJA-ja operon një sistem nëpërmjet të cilit profesionistët e kujdesit shëndetësor ose anëtarët e publikut mund të raportojnë çdo reaksion të dyshuar negativ (efektet anësore) që kanë të bëjnë me barnat dhe vaksinat që kanë ndodhur në Irlandë.

HPRA-ja e nxit fuqishëm raportimin e reaksioneve negative të dyshuara (efekteve anësore) që kanë lidhje me vaksinën e COVID-19 për të mbështetur monitorimin e vazhdueshëm të sigurisë së tyre dhe përdorimin e efektshëm. Për të raportuar një reaksion negativ të dyshuar ndaj vaksinës COVID-19, ju lutemi vizitoni **www.hpra.ie/report**

Ju mund t'i kërkonte edhe mjekut tuaj të familjes ose një anëtar të familjes që ta raportojë këtë për ju. Duhet dhënë sa më shumë informacion nga informacioni që dihet dhe kur është e mundur, numri i grupit të vaksinës duhet të përfshihet.

HPRA-ja nuk mund të japë këshilla klinike mbi raste individuale. Anëtarët e publikut duhet të kontaktojnë profesionistët e tyre të kujdesit shëndetësor (Mjekun ose Farmacistin e tyre) për çdo problem mjekësor që mund të kenë.

Informacioni juaj personal

Për ta administruar vaksinën në mënyrë të sigurt dhe për të regjistruar të gjitha informacionet e nevojshme për të monitoruar dhe menaxhuar vaksinën, HSE-ja do ta përpunojë informacionin personal të fëmijës suaj. I gjithë informacioni i përpunuar nga HSE-ja do të jetë në pajtim me ligjet e përgjithshme dhe në veçanti me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) që ka hyrë në fuqi në vitin 2018.

Përpunimi i të dhënave të fëmijës suaj do të jetë i ligjshëm dhe i drejtë. Ato do të përpunohen vetëm për qëllime specifike për të menaxhuar vaksinimet. Është zbatuar parimi i Minimizimit të të Dhënave. Kjo do të thotë se vetëm të dhënat që janë të nevojshme për të identifikuar fëmijën tuaj, për të rezervuar takimin e tij, për të regjistruar vaksinën dhe për të monitoruar efektet e saj po regjistrohen.

Ju keni të drejtat e mëposhtme si një subjekt i të dhënave sipas GDPR në lidhje me të dhënat personale të fëmijës suaj që janë përpunuar.

- Të kërkonte informacion dhe qasje në të dhënat tuaja personale të fëmijës suaj (që zakonisht njihet si një 'kërkesë për qasje në të dhënat e subjektit'). Kjo ju mundëson juve (prindit të fëmijës ose kujdestarit ligjor) të merrni një kopje të të dhënave personale që ne mbajmë për fëmijën tuaj dhe të kontrolloni se ne po i përpunojmë ato në mënyrë të ligjshme.
- Të kërkonte ndreqjen e të dhënave personale që ne mbajmë për fëmijën tuaj. Kjo ju mundëson të korrigjohet çdo informacion i paplotë ose i pasaktë që ne mbajmë mbi fëmijën tuaj.
- Të kërkonte fshirjen e të dhënave personale të fëmijës suaj. Kjo ju mundëson juve të na kërkonte të fshijmë ose heqim të dhënat personale të fëmijës suaj kur nuk ka një arsye të fortë që ne të vazhdojmë t'i përpunojmë. Ju gjithashtu keni të drejtën të na kërkonte të fshijmë ose heqim informacionin personal të fëmijës suaj kur keni ushtruar të drejtën tuaj ta kundërshtoni përpunimin.
- Të kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja personale.

Më shumë informacion gjendet në www.hse.ie/eng/gdpr

Skanoni kodin QR për të gjetur vizatimin komik të HSE të quajtur *Duke bërë vaksinën COVID-19* në **sektorin e burimeve për fëmijë**. Ky vizatim komik mund të jetë i dobishëm për të ndihmuar në përgatitjen e fëmijëve më të rritur për atë që i pret kur të shkojnë për të bërë vaksinën COVID-19.





**COVID-19
VACCINE**
Public Health
Advice

Botuar nga HSE më 8 maj 2023
Për informacion më të përditësuar
vizitoni faqen www.hse.ie



Rialtas na hÉireann
Government of Ireland